

**Banka OTP Albania**  
**Kodi i Etikës**

## Mesazh nga Drejtori i Përgjithshëm i Grupit OTP Nyrt.

I nderuar Lexues,

Grupi OTP Bank është një nga pjesëmarrësit më të spikatur të tregut në Hungari dhe rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore. Sekreti i suksesit tonë është se falë vendndodhjes së selisë sonë qendrore në rajonin e EQL, përvojës sonë 70 vjeçare dhe 17 milionë klientëve tanë , ne i kuptojmë kërkesat e klientëve dhe jemi në gjendje t'i kënaqim ato në mënyrë efikase. Përkushtimi pa kufij i kolegëve tanë, mendësia e tyre e hapur ndaj zgjidhjeve të reja dhe kreativiteti e tyre garantojnë suksesin tonë në të ardhmen.

Përveç rritjes së vlerës së aksionarëve, përfitimit dhe efikasitetit, menaxhimi i riskut dhe funksionimi i ligjshëm, si dhe zbatimi efikas i kontrollit të biznesit, etikës dhe kontrollit të brendshëm kanë një rëndësi të madhe në funksionimin e Bankës.

Si një institucion etik dhe që respekton ligjin, Banka dhe e gjithë administrata e saj është e përkushtuar të veprojë në përputhje me të gjitha ligjet, duke përfshirë ligjet kundër korrupsionit, dhe ndjek parimin e tolerancës zero për sa i përket korrupsionit dhe mitmarrjes/ryshfetit - Banka është rreptësisht kundër të gjitha formave të korrupsionit, dhe mbështet fuqishëm sjelljen antikorrupsion.

Punonjësit tanë të përkushtuar dhe me njohuri gjithëpërfshirëse, që veprojnë sipas standardeve tona të larta të etikës, janë çelësi i suksesit tonë. Të gjithë punonjësit e Grupit të Bankës OTP pritët të realizojnë punën e tyre në përputhje të plotë me standardet etike dhe profesionale.

Funksionimi transparent, si dhe harmonizimi i interesave të klientëve dhe të bankës janë të një rëndësie të madhe. Jemi të bindur se funksionimi sipas standardeve të etikës kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e performancës dhe konkurrencës së Bankës, si dhe në reputacionin e saj ndërkombëtar dhe brenda vendit.

Baza dhe udhëzimet e funksionimit etik të biznesit janë përmbledhur në Kodin e Etikës. Familjarizimi dhe pajtueshmëria me dokumentin, dhe monitorimi i ndryshimeve janë kërkesa thelbësore për tu përmbushur nga të gjithë punonjësit dhe agjentët tanë.

Dr. Sándor Csányi

Kryetari dhe Drejtori i Përgjithshëm

*“Banka OTP Albania, si pjese e Grupit Bankar Hungarez, OTP Bank Plc angazhohet të veprojë në përputhje me të gjitha dispozitat e parashikuara në këtë Kod Etike duke patur si kryefjalë integritetin dhe përgjegjësinë në rolin tonë si bankierë dhe përmbushjen e misionit tonë si Bankë. Synimi ynë për të qenë ndër bankat më të mira, në madhësi dhe cilësi dhe për t'u bërë banka referencë për sa i përket shërbimit, cilësisë së produkteve dhe zgjidhjeve innovative bazohet së pari në punën e kualifikuar të punonjësve tanë dhe veçanërisht sjelljes së tyre etike.*

*Për të siguruar implementimin e të gjitha kërkesave të Kodit të Etikes, ne kemi një komitet të dedikuar që vepron si organi i brendshëm përgjegjës për trajtimin e rasteve specifike të shkeljes së procedurave nga stafi i bankës, rasteve të mashtrimit brenda bankës ose rasteve të tjera specifike që lidhen me veprimet e dyshimta të stafit, duke përfshirë edhe çështjet në lidhje me sjelljen etike sipas deklaratave të bëra në përgjithësi ose në raste individuale dhe vendimet e Bankës që lehtësojnë interpretimin e rregullave. Ky komitet duhet të tregojë qëndrimin e tij në raste të përgjithshme dhe specifike për sa i përket zbatimit të Kodit të Etikës dhe të japë rekomandime për përmirësimin e vazhdueshëm të Kodit të Etikës në bazë të punës praktike dhe përvojave të tij. Çdo anëtar i komitetit është plotësisht i përkushtuar në operacionet etike të Bankës.”*

*Bledar Shella*

*Drejtor i Përgjithshëm i Bankës OTP Albania*

*Kryetari, House Committee i Bankës OTP Albania*

## 1. Hyrje

Kodi i Etikës së Bankës OTP Albania (në vijim referuar si "Banka") formulon udhëzime dhe kërkesa të qarta dhe të pagabueshme si për Bankën, ashtu edhe për degët e saj, në lidhje me operacionet etike të biznesit, me qëllim mbrojtjen e vlerave të Bankës.

Banka miratoi Kodin e Etikës të Grupit në përputhje me ndryshimet dhe kërkesat e jashtme dhe të brendshme, Kod i cili i nënshtrohet ndryshimeve dhe zhvillimeve të vazhdueshme. Kodi i Etikës bazohet në standarde ndërkombëtare, praktikat më të mira dhe përvojat e veta operacionale, të cilat marrin në konsideratë kërkesat e vendosura për Bankën dhe realizimin e tyre praktik.

Sistemi i qeverisjes së korporatës të Bankës i shërben njëkohësisht besimit dhe kënaqësisë së klientit, rritjes së vlerës së aksionarëve dhe përgjegjësisë sociale.

Pajtueshmëria me rregullat e etikës dhe funksionimin etik brenda Bankës mbikëqyret nga House Committee, në përputhje me parimet dhe format e pritura të sjelljes të përcaktuara në Kodin e Etikës.

Banka ofron mundësinë që këto shkelje të Kodit të Etikës të raportohen qoftë personalisht, përmes telefonit ose me postë elektronike; për më tepër, banka ndërmerr çdo veprim të mundshëm për të mbrojtur punonjësit që raportojnë shkelje nga diskriminimi dhe trajtimi i padrejtë: banka ndalon aplikimin e masave hakmarrëse ose pasojave negative ndaj kujtqdo që raporton në mirëbesim çdo shkelje të supozuar ose të vërtetë të vlerave dhe parimeve të Kodit të Etikës.

Banka i kushton një rëndësi të veçantë faktit që punonjësit duhet të njihen mirë dhe të sensibilizohen lidhur me normat e etikës, ndaj dhe për këtë arsye ajo organizon programin e leksioneve elektronike (e-learning) për çdo punonjës, dhe ndërkohë rishikon dhe monitoron rregullisht respektimin e këtyre normave.

## 2. Objekti personal i Kodit të Etikës

Kodi i Etikës specifikon detyrimet e drejtuesve të lartë të Bankës dhe anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të saj (në vijim referuar bashkërisht si "drejtuesit ekzekutiv"), punonjësve<sup>1</sup> të saj (të lartpërmendurit në vijim referuar bashkërisht si "punonjësit") dhe agjentëve të saj. Për qëllimet e Kodit të Etikës "agjentët" do të konsiderohen të gjithë përfaqësuesit, ekspertët, ndërmjetësit, konsulentët, vetë agjentët, nënkontraktorët dhe furnitorët, së bashku me sipërmarrjet dhe personat fizikë në marrëdhënie të tjera juridike me Bankën në bazë të legjislacionit civil. Dispozitat e përcaktuara në Kodin e Etikës duhet të përmbushen dhe të respektohen nga të gjithë personat dhe organizatat e lartpërmendura gjatë gjithë periudhës së punës së tyre ose marrëdhënieve kontraktuale, gjatë dhe jashtë orarit të punës.

Punonjësit dhe agjentët që përmbushin detyrime kontraktuale për Bankën dhe që, gjatë veprimtarisë së tyre, organizojnë takime me një gamë të gjerë klientësh ekzistues ose potencial të Bankës, duke u ofruar kështu këtyre klientëve shërbime në emër të Bankës, dhe që gjatë rrjedhës së përmbushjes së këtyre detyrimeve kontraktuale prezantohen qartazi para publikut si përfaqësues të Bankës dhe pranojnë Kodin e Etikës duke nënshkruar deklaratat e përfshira në të.

## 3. Vlerat

### 3.1 Mbrojtja e aseteve të Bankës

Çdo punonjës është përgjegjës për mbrojtjen e të gjitha aseteve materiale, financiare dhe aseteve të tjera të Bankës, për mbrojtjen e klientëve dhe agjentëve që u janë caktuar të menaxhojnë. Asetet e Bankës, klientët, agjentët dhe aktorët e tjerë mund të aplikohen dhe përdoren vetëm për qëllime të autorizuara, në përputhje me lejet dhe kushtet e zbatueshme.

Menaxhimi i gabuar ose shkëmbimi e paautorizuar me palë të treta i aseteve në pronësi ose që përdoren nga Banka konsiderohet si shkelje e detyrimeve ndaj Bankës dhe si e tillë, mund të cilësohet si krim ekonomik kundër Bankës. Po ashtu, pakujdesia, shpërdorimi ose përdorimi i paautorizuar i aseteve të Bankës mund të përbëjë shkelje të detyrimeve ndaj Bankës.

---

<sup>1</sup> punonjësit: persona që kanë një marrëdhënie pune ose ndonjë marrëdhënie tjetër për qëllime pune me Bankën.

Për qëllimet e këtij Kodi, asetet nënkuptojnë para, tituj, prona fizike (instrumente, inventarë, pajisje, etj.), shërbime, plane biznesi, informacione që lidhen me klientët, punonjësit dhe agjentët, pronësia intelektuale dhe çdo informacion tjetër personal që është i mbrojtur me ligj dhe konfidencial.

### **3.2 Mbrojtja e reputacionit të Bankës**

#### **Kërkesat në lidhje me sjelljen**

Punonjësit tanë, brenda dhe jashtë vendit të punës - duhet të përmbahen dhe të mos përdorin shprehje që mund të ketë ndikim negativ në reputacionin e Bankës.

Në një ambient të mirë pune nuk duhet të evidentohen raste ngacmimi, kërcënime, diskriminime, tone të pahijshme dhe gjuhë abuzive, si në marrëdhëniet mes punonjësve ashtu edhe në marrëdhëniet epror - vartës; udhëzimet (e stafit drejtues) dhe veprimet që cenojnë dinjitetin njerëzor të punonjësve janë rreptësisht të ndaluara.

Nuk inkurajohen rastet dhe vazhdimësia e marrëdhënieve financiare dhe varësisë financiare (p.sh. marrja hua) ndërmjet punonjësve<sup>2</sup>.

Është thelbësore që të përdoret toni, gjuha, sjellja dhe gjestet e përshtatshme në komunikimin me klientët dhe agjentët; në këtë drejtim, Banka pret dhe e konsideron si shumë të rëndësishme shfaqjen e një sjelljeje shembullore e stafit të lartë drejtues.

Banka pret që punonjësit e saj të sillen, edhe në jetën e tyre private, në përputhje dhe në një mënyrë që konsiderohet e denjë për normat e etikës së Bankës, veçanërisht kur aktivitetet e tyre ose kur vetë punonjësit mund të krijojnë ndonjë lloj lidhje në ndonjë lloj forme me Bankën ose kur ata mund të duket se veprojnë ose shprehin mendime në emër të Bankës.

Punonjësit mund të marrin pjesë dhe të shprehin mendimet e tyre në çdo organizatë (politike, fetare ose kulturore) vetëm si individë privatë. Në këto raste, ata nuk duhet të përmendin apo të shprehin asnjë referencë për lidhjen e tyre me Bankën.

Punonjësit nuk duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre të shprehjes në asnjë mënyrë që të cenojë reputacionin e Bankës ose interesat e saj të ligjshme ekonomike ose organizative.

#### **Mediat sociale**

Gjatë veprimtarisë së tyre në mediat sociale, punonjësit tanë nuk duhet të shfaqin asnjë shprehje që mund të ketë ndikim negativ në reputacionin e Bankës. Banka pret që punonjësit e saj të sillen, edhe

---

<sup>2</sup> Kjo dispozitë në lidhje me zhvillimin e marrëdhënieve financiare nuk vlen për punonjësit në marrëdhënie familjare.

në komunikimet e tyre në mediat sociale si individë privat, në përputhje dhe në një mënyrë që konsiderohet e denjë për normat e etikës së Bankës, veçanërisht kur aktivitetet e tyre ose kur vetë punonjësit mund të krijojnë ndonjë lloj lidhje në ndonjë lloj forme me Bankën ose kur ata mund të duket se veprojnë ose shprehin mendime në emër të Bankës.

Për këtë arsye, gjatë veprimtarisë së tyre në mediat sociale, punonjësit tanë duhet veçanërisht

- të tregojnë respekt dhe tolerancë ndaj të tjerëve për sa i përket origjinës së tyre fetare, kombësisë dhe origjinës etnike, orientimit seksual, bindjeve politike ose ideologjike;
- të mos postojnë propagandë urrejtjeje ose përmbajtje raciste;
- të respektojnë të drejtat kushtetuese dhe statutore të të tjerëve;
- të tregojnë respekt edhe ndaj konkurrencës së Bankës;
- të mos postojnë me qëllim informacione të rreme, çorientuese apo jo të vërteta;
- të mos postojnë përmbajtje ose informacione të paligjshme që nxisin veprime të paligjshme;
- të mos postojnë shprehje vulgare, të turpshme, shpifëse apo përgojuese.

### **Përfshirja politike**

Ne e njohim të drejtën e punonjësve tanë për të ndërmarrë role në politikë dhe në jetën publike, por të tilla aktivitete mund të kryhen vetëm jashtë vendit të punës dhe në këto aktivitete ata nuk duhet të përfshijnë Bankën dhe/ose Grupin. Gjatë veprimtarisë së tyre politike jashtë vendit të punës, punonjësit nuk duhet të keqpërdorin pozicionet e tyre të punës në Bankë dhe sjellja e tyre në asnjë mënyrë nuk duhet të ketë ndikim negativ në reputacionin e Bankës.

Punonjësit duhet të informojnë Bankën përpara se të marrin përsipër ndonjë pozicion në ndonjë organizatë politike ose shtetërore. Gjatë punës së tyre në Bankë, punonjësit nuk mund të keqpërdorin rolet ose pozicionet e tyre në organizata politike ose shtetërore.

Punonjësit mund të ofrojnë mbështetje vetëm për organizatat politike ose personat që respektojnë këtë ndalim, siç citohet në Kapitullin "Sponsorizimi". Burimet e Bankës (burimet njerëzore, objektet, asetet e tjera) nuk duhet të përdoren në mbështetje të ngjarjeve politike.

### **3.3 Procedura e duhur dhe e përshtatshme**

#### **Antikorrupsioni**

##### Korrupsioni, manipulimi i ndaluar

Manipulimi i ndaluar është sigurimi ose përfitimi i avantazheve pa të drejtë ose të paligjshme, në këmbim të përfitimeve materiale ose jo materiale. Asnjë punonjës dhe asnjë person tjetër që vepron

në emër të Bankës nuk duhet kurrë të ofrojë, premtojë ose bëjë ndonjë pagesë apo të ofrojë ndonjë send tjetër me vlerë, apo përndryshe të kërkojë ose të pranojë të tilla sende me vlerë me qëllim ndikimin e nëpunësve publik ose personave të tjerë (apo të jetë shkak për shfaqjen e ndonjë ndikimi të tillë), ose të përfitojë avantazhe biznesi që nuk i takojnë.

Në sendet me vlerë përfshihen përfitime financiare ose lloje të tjera përfitimesh, të tilla si, përveç parave *cash*, dhurata, kredi/hua, kolateral, çdo ofrim tjetër gjatë marrjes së një kredie, zbritje, argëtim, shërbime, përfitime, ofrim i një vendi pune, etj. Këtu nuk përcaktohet asnjë shumë minimale ose vlerë kufi i çfarëdo lloj natyre që duhet të tejkalohet që kjo pagesë apo dhuratë e dhënë për qëllimet e mësipërme të klasifikohet si e paligjshme ose në kundërshtim me Kodin e Etikës.

Duhet të shmangen edhe çdo dyshim apo shfaqje korrupsioni dhe manipulim i ndaluar.

### Dhuratat

Dhënia e dhuratave shpesh është pjesë e kulturës dhe traditave vendase. Dhënia e dhuratave në marrëdhëniet e biznesit dhe me klientët mund të kontribuojë në rritjen e reputacionit të shoqërisë dhe në krijimin e marrëdhënieve të mira të biznesit.<sup>3</sup> Mund të jepen dhe të pranohen dhurata të zakonshme për qëllime biznesi; megjithatë, vlera totale monetare e dhuratave të dhëna ose të pranuar brenda një viti nuk duhet të kalojë shumën 150 Euro<sup>4</sup>. Përfitimet e përsëritura, përfitimet e rregullta (ditore, javore ose mujore) të ofruara nga i njëjti klient ose e njëjta klientelë nuk klasifikohen si dhurata biznesi, dhe për rrjedhojë, nuk duhet të pranohen. Asnjë dhuratë e çfarëdo lloj natyre, pavarësisht nga vlera, nuk duhet të pranohen në ambientet publike të pritjes së klientëve. Dhurata nuk duhet të jetë në para *cash* apo përfitim plotësues që jepet në ambientet e punës apo që lidhet drejtpërdrejt me shërbimet bankare.

Nëse, përkundër sa më sipër, ofrohet një dhuratë që e tejkalon kufirin e vlerës së përmendur më parë, dhe kjo dhuratë nuk duhet të refuzohet, ajo duhet t'i raportohet funksioneve të Sektorit të Përputhshmërisë së Bankës, duke specifikuar organizatën ose personin nga i cili/nga është marrë dhurata, natyrën e marrëdhënies së biznesit dhe vetë dhuratën.

<sup>3</sup> Në lidhje me shërbimet e investimeve, punonjësit duhet të veprojnë gjithashtu në përputhje me dispozitat e dokumentit të brendshëm rregullues të Bankës që përmban parimet dhe rregullat e nxitjes.

<sup>4</sup> Çdo vit, personi që merr dhurata mund të pranojë dhurata deri në vlerën maksimale 150 Euro, pavarësisht numrit të dhuratave dhe/ose kontribuesve. Vlera maksimale përfshin gjithashtu vlerën e një dhurate të marrë nga një pozicion funksional ose nga një njësi organizative, por që i jepet një punonjësi me vendim të eprorit të tij.



Ndalohet çdo formë e shkëmbimit të dhuratave ndërmjet punonjësve në dëm të punëdhënësit (buxheti përfaqësues), qoftë brenda një institucioni ose mes punonjësve që i përkasin filialeve të ndryshëm të Grupit. Dhuratat mund të jepen nga punonjësit si persona privatë, me shpenzimet e tyre (p.sh. në se dikush ka ditëlindjen).

Nga ky ndalim përjashtohen dhuratat jo në para të natyrës protokollare për personat në nivel të lartë drejtues<sup>5</sup>, qëllimi i të cilave nuk është të ndikojë në marrëdhëniet e biznesit ekzistues ose që do të lidhet me Bankën.

Një punonjës nuk duhet të japë apo të pranojë dhurata në rrethana kur për të huajt mund të duket sikur kjo dhuratë mund të influencojë një vendim biznesi ose kur mund të konsiderohet si rast ryshfeti.

Duhet të shmangen edhe rastet kur thjesht ka dyshime ose duket sikur Banka ose punonjësit e saj influencojnë ose përpiqen të influencojnë organet zyrtare; për rrjedhojë, duhet treguar kujdes i veçantë në lidhje me dhuratat dhe ftesat kundrejt organeve zyrtare, organizatave ndërkombëtare dhe/ose të shoqërisë civile.

Një ftesë ose ngjarje argëtuese mund të marrë forma të ndryshme, duke përfshirë aktivitete të organizuara, mikpritje, koncerte ose udhëtime. Ftesat ose pranimiti i tyre mund të jetë pjesë e ligjshme e operacioneve të biznesit. Ajo mund të kontribuojë në reputacionin e Bankës dhe në krijimin e marrëdhënieve të mira të biznesit. Lejohet të bëhen ose të pranohen ftesa për qëllime biznesi. Këto raste mund të përfshijnë ftesa për drekë ose darkë, pjesëmarrje në pritje të ndryshme ose lloje të tjera aktiviteteve argëtuese, siç janë akomodimi ose rimbursimi i kostove të udhëtimit. Megjithatë, kostot e tilla duhet të mbahen gjithmonë brenda kufijve të arsyeshëm, kur "kufiri i arsyeshëm" varet nga situata aktuale.

Vendimet e biznesit duhet të merren gjithmonë në përputhje me interesat e Bankës dhe jo në bazë të marrëdhënieve personale, zhvillimi i së cilave është lehtësuar nga dhurata apo ftesa të kësaj natyre. Qëllimi kryesor është mbrojtja dhe ruajtja e reputacionit të Bankës dhe integritetit të pacenuar.

---

<sup>5</sup> Për qëllimet e këtij dokumenti, staf i lartë drejtues nënkupton nëpunësit ekzekutiv të specifikuar në këtë Kod Etike, d.m.th. anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të Bankës, Bordin Mbikqyrës, Drejtorin e Përgjithshëm, Zëvendës drejtorët e Përgjithshëm, si dhe anëtarët dhe të ftuarit e përhershëm të Komitetit të Menaxhimit të Bankës.

### Pagesat që lehtësojnë procedurat e biznesit

Në pagesat lehtësuese përfshihen përfitimet jozyrtare që synojnë lehtësimin dhe përsheptimin e një veprimi ose procedure që personi që paguan ka të drejtë të përfitojë. Banka nuk e zbaton praktikën e pagesave lehtësuese dhe nuk do të procedojë asnjë pagesë të tillë kur të kërkohet.

### Sponsorizimi

Punonjësve të Bankës, në lidhje me aktivitetet që lidhen me marrëdhëniet e tyre të punës ose pozicionet që mbajnë, nuk u lejohet të ofrojnë mbështetje financiare ose jo financiare për asnjë parti politike, organizatë politike apo anëtar ose përfaqësues të tyre. Banka pajtohet dhe pranon të veprojë në përputhje të plotë me këtë parim.

### Donacionet

Në kuadër të përgjegjësisë së saj sociale, Banka siguron donacione për organizata dhe grupe të caktuara në nevojë. Donacionet mund të ofrohen vetëm në përputhje me dokumentacionin statutor dhe rregullator të brendshëm në fuqi. Banka dhe asnjë nga punonjësit e saj nuk mund të kërkojë apo të pranojë asnjë të mirë materiale apo jo materiale të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në këmbim të një donacioni.

### **Konfliktet e interesit**

Në përputhje me dispozitat e rregulloreve statutorë në fuqi dhe dokumenteve rregullatore të Bankës, punonjësit duhet të shmangin çdo konflikt interesi dhe madje edhe çdo shenjë të tij në lidhje me pozicionin e punës, punën dhe veten e tyre. Ata nuk duhet të kryejnë asnjë lloj aktiviteti që është në kundërshtim me interesat e Bankës dhe/ose të klientëve të saj dhe duhet të marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

Punonjësit duhet të raportojnë çdo konflikt aktual ose të mundshëm interesi në lidhje me veten e tyre, të afërmit e tyre, interesat e biznesit të tyre ose të afërmit të tyre dhe interesat e Bankës ose klientëve të saj. Punonjësit duhet të bashkëpunojnë me menaxherin e tyre të linjës dhe Sektorin e Përputhshmërisë për të zgjidhur shpejt dhe në mënyrë efektive çdo konflikt interesi.

Në lidhje me pozicionet e tyre, punën dhe/ose interesat e Bankës, punonjësit nuk duhet të shfaqin sjellje ose të mbajnë ndonjë pozicion që rezulton në konflikt interesi.

Në rast se banka në veprimtarinë e saj do të marrë në konsideratë shërbimin e investimeve dhe aktivitete të ndryshme të ofrimit të shërbimeve ndihmëse, Banka përgatit një politikë mbi konfliktin e interesit në mënyrë që të shmangë, identifikojë dhe menaxhojë çdo konflikt interesi që cenon klientët e saj. Politika e konfliktit të interesit specifikon rrethanat që çojnë ose mund të çojnë në të tillë konflikt interesi në rastin e një investimi të caktuar ose shërbimeve ndihmëse që mund të sjellin

pasoja të dëmshme për klientin, dhe ajo parashton rregullat e detajuara procedurale dhe masat që duhet të zbatohen për menaxhimin e këtij konflikti interesi.

### **3.4 Respekti reciprok**

#### **Diskriminimi**

Banka përpiqet të krijojë një mjedis pune ku diferencat individuale pranohen dhe vlerësohen. Janë të ndaluara të gjitha format negative të diskriminimit të drejtpërdrejta ose të tërthorta të bazuara në attribute reale ose të supozuara të një personi të caktuar, duke përfshirë por pa u kufizuar në racë, seks, kombësi, bindje fetare ose ideologjike, identitet seksual, origjinë etnike, aftësi të kufizuar, orientim seksual, pikëpamje politike ose pikëpamje të tjera, statusi martesor, etj.

#### **Ngacmimi**

Banka ndalon dhe nuk toleron asnjë sjellje të bazuar në situata intimiduese për punonjësit, veçanërisht në raste kur punonjësit detyrohen të tregojnë një sjellje që nuk është në përputhje me dokumentet rregullatore të Bankës ose rregulloret statutores në fuqi.

Është e ndaluar çdo formë sjelljeje verbale, joverbale ose fizike që synon ose rezulton në cenim të dinjitetit të një personi të caktuar ose krijimin e një mjedisi intimidues, armiqësor, degradues, agresiv, poshtërues ose fyes.

Nëse një punonjës mendon se ai/ajo është viktimë e ngacmimit të përmendur më sipër, ai/ajo duhet të njoftojë menjëherë Sektorin e Përputhshmërisë së Bankës dhe të ushtrojë të drejtat e tij/saj të sinjalizuesit përmes kanaleve të komunikimit të përcaktuara në Seksionin 4. Çështja do të hetohet me qëllim që të merren masat e nevojshme.

### **3.5 Angazhimet e Bankës**

#### **Raportimi Financiar**

Banka përgatit, prezanton dhe boton raportet e saj financiare në përputhje me parimet e përgjithshme të pranuar të kontabilitetit dhe rregulloret statutores në fuqi. Raportet duhet të përmbajnë pozicionin financiar të Bankës dhe rezultatet e operacioneve të saj në të gjitha aspektet përkatëse, duke siguruar kështu ofrimin e informacionit të drejtë për investitorët e saj.

#### **Ligji i Konkurrencës**

Stafi drejtues i Bankës është i angazhuar dhe i interesuar në garantimin e kushteve të lira dhe të ndershme të tregut që lehtësojnë konkurrencën. Banka shmang shfaqjen e çdo sjelljeje që mund të shkaktojë kufizim të konkurrencës në treg apo abuzime me pozicionin e saj dominues ekonomik. Një

sjellje e tillë mund të përfshijë, ndër të tjera, konkurrencë të padrejtë ekonomike (në një mënyrë që shkel ose cenon interesat e ligjshme të klientëve, konkurrentëve dhe/ose partnerëve); dhënie ose pranim të propozimeve që synojnë vendosjen e çmimeve, shkëmbimin e informacionit të marketingut që ndikon në konkurrencë ose ndarjen e tregut dhe klientëve (marrëveshja e kartelit); dhe diskutime për çështje me rëndësi nga aspekti i kufizimit të konkurrencës (p.sh. çmimet, politikat e vendosjes së çmimeve, kostot, strategjitë e marketingut) në takime me organizata profesionale që përfaqësojnë interesat tregtare.

Gjatë aktiviteteve të tyre të përditshme që përfshijnë konkurrentët e Bankës dhe partnerët e biznesit, punonjësit duhet të sillen duke pasur dijeni të plotë të përgjegjësive të tyre, sipas ligjit të konkurrencës.

### **Shkëmbimi i informacionit të brendshëm**

Gjatë punës së tyre të përditshme, disa punonjës të Bankës mund të marrin informacione të brendshme, të cilat ata nuk duhet të përdorin në asnjë mënyrë në kundërshtim me ligjin. Banka dënon shkëmbimin e informacionit të brendshëm.

Shkëmbimi i informacionit të brendshëm, dhënia e paautorizuar e informacionit të brendshëm dhe manipulimi i ndaluar i tregut rregullohen nga dispozitat ligjore, legjislacioni përkatës i BE-së, si dhe dokumentet rregullatore të brendshme të Bankës.

Në përputhje me dokumentet e saj të brendshme rregullatore, Banka merr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe ndaluar shkëmbimin e informacionit të brendshëm.

### **Konfidencialiteti**

Një nga kërkesat më thelbësore për marrëdhëniet konfidenciale midis Bankës dhe klientëve të saj është mbrojtja rigoroze e sekreteve të biznesit dhe informacionit konfidencial që ka të bëjë me klientët. Në mënyrë të vazhdueshme, Banka mbron sekretet e biznesit dhe të titujve që rrjedhin nga veprimtaria financiare e biznesit. Punonjësit duhet të veprojnë në përputhje me detyrimin e konfidencialitetit edhe pasi të kenë ndërprerë marrëdhëniet ose statusin e tyre të punës.

Punonjësit nuk duhet të shkëmbejnë zyrtarisht dhe as jo zyrtarisht asnjë informacion që lidhet me funksionimin dhe aktivitetet e Bankës në rastet kur kjo nuk kërkohet në procedurat e rregullta të biznesit dhe as në detyrat e punonjësit dhe në raste kur përfshihen persona që nuk janë punonjës ose partnerë biznesi të Bankës.

Mbrojtja dhe ruajtja e sekretit të biznesit, bankës dhe titujve duhet të garantohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit nr.9988, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 31 të Bankës së

Shqipërisë, datë 08.05.2002 "Për Sekretin Bankar", Udhëzimit nr. 20, datë 03.08.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave "Për përpunimin e të dhënave personale në industrinë bankare", dhe rregulloreve të brendshme të Bankës.

Punonjësit tanë janë të detyruar të zbatojnë kërkesat e politikës së procedurave të pastra të Bankës dhe të sigurohen që në fund të ditës së punës, shkresat fizike dhe dokumentet e tjera elektronike që përmbajnë informacione konfidenciale ose sekrete për bankën, titujt ose sekrete biznesi të mos lihen në vende dhe/ose në një mënyrë të aksesueshme nga persona të paautorizuar.

### **Aktivitetet kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit**

Ofruesit e shërbimeve financiare luajnë një rol ndërmjetës ose përfitues në realizimin e operacioneve të shpejta dhe të sigurta në tregun e parave për individë privatë dhe për organizata. Për rrjedhojë, ekziston një rrezik i lartë që individë të caktuar të synojnë të lëshojnë urdhra për transaksione përmes Bankës për qëllime të paligjshme ose që përfshijnë asete me origjinë nga veprimtaritë kriminale. Parandalimi i akteve të tilla dhe njohja e klientëve të Bankës është jashtëzakonisht e rëndësishme, jo vetëm për Bankën, por edhe për qëllime të perceptimit të përgjithshëm të tregut të brendshëm të parasë dhe kapitalit. Në këtë drejtim, çdo akt i paligjshëm mund të sjellë pasoja të paparashikueshme për Bankën dhe tregun sa i përket humbjes së reputacionit dhe humbjeve të mundshme financiare.

Kur kanë kontakte të drejtpërdrejta me klientët dhe kur janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të mësipërme, punonjësit e Bankës duhet të ndërmarrin sa më shumë hapa të qartë për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të marrin sa më shumë informacione shteruese për klientët e tyre në zbatim të parimit "Njihni klientin tënd". Gjatë punës së tyre, ata duhet të veprojnë në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", Rregulloren nr. 44 të Bankës së Shqipërisë "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" dhe rregulloret dhe udhëzimet e brendshme të Bankës për "Njihni klientin tënd", Parandalimin e Pastrimit të Parave, Sanksionet dhe Embargot, etj.

### **Një mjedis i sigurt dhe i shëndetshëm pune**

Punonjësve tanë u sigurohet një mjedis i shëndetshëm dhe modern pune, në përputhje me rregulloret përkatëse të punës. Ne sigurojmë mbrojtjen e integritetit dhe shëndetit të tyre trupor. Banka u siguron punonjësve të saj trajnime për mbrojtjen në ambientet e punës dhe mbrojtjen nga zjarri.

Është rreptësisht i ndaluar konsumimi dhe/ose përdorimi i alkoolit, substancave të paligjshme, drogës dhe/ose substancave të tjera që ndikojnë shëndetin mendor në vendet e punës në Bankë, në vende të tjera dhe/ose në çdo rast tjetër që lidhet me punën për llogari të Bankës, dhe/ose gjatë çdo lloj veprimtarie që lidhet me punën. Gjithashtu, do të klasifikohet si abuzim edhe paraqitja në punë nën ndikimin e tyre ose kryerja e aktiviteteve që lidhen me to (ofrimi, dorëzimi, shpërndarja, etj.). Konsumimi i civilizuar dhe i moderuar i alkoolit lejohet vetëm në aktivitete protokollare dhe aktivitete të tjera që nuk lidhen me punën ose bankën.

Të gjithë punonjësit duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e shëndetit dhe sigurisë në punë që kanë të bëjnë me punën, në përputhje me rregullat përkatëse të sigurisë, punës dhe mbrojtjes nga zjarri.

Banka vazhdimisht vepron në përputhje me rregulloret statutoare vendase dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me krijimin dhe mirëmbajtjen e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm të punës.

#### 4. Raportimi i çështjeve të etikës, këshillimi

Nëse dyshoni ose keni marrë dijeni për shkelje të mundshme të vlerave të përcaktuara në Kodin e Etikës (çështje etike), kur keni nevojë për këshilla ose kur thjesht keni pyetje në përgjithësi, ose nëse nuk dini si të procedoni në një situatë të caktuar, janë vendosur në dispozicion opsionet e mëposhtme:

- Kontakt i drejtpërdrejtë me Sektorin e Përputhshmërisë dhe AML në Banën OTP Albania (në një kohë të paracaktuar),
- Me e-mail në adresën: [whistleblowing@otpbank.al](mailto:whistleblowing@otpbank.al)
- Me letër zyrtare në adresën:

Banka OTP Albania sh.a,  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 9  
Tiranë, Shqipëri

Njoftimet, kërkesat dhe investigimet janë trajtuar çdo herë me konfidencialitet nga Banka, duke respektuar rregulloret e zbatueshme statutores dhe rregullat e brendshme, dhe rrjedhimisht duke mbrojtur personin që raporton.

Në rast të shkeljes së Kodit të Etikës, procedurat dhe sanksionet zbatohen në përputhje me parimet e përcaktuara në dokumentet rregullatore të brendshme të Bankës. Me konstatimin e një shkelje të Kodit të Etikës, Banka nis procedurat e punës (zbaton sanksione diskriminuese).

Çështjet e etikës mund të raportohen duke ruajtur anonimitetin. Në këtë rast duhet të merret parasysh se ne mund të mos jemi në gjendje të mbledhim informacione shtesë të nevojshme për hetimin dhe zgjidhjen e çështjes, prandaj Banka këshillon personin që raporton të vendosë në dispozicion të dhënat e kontaktit, duke e ruajtur këtë person anonim, në mënyrë që ne të mund të kërkojmë detajet e nevojshme.

Njoftimet e pabazuara ose dashakeqëse (shpifje) nuk janë të mirëpritura dhe mund të sjellin pasoja ligjore.